


Pranuar me dt. 23.2.2018

Nj. org.	Numër	Nr. ekzempl.	Vlera
01	424		



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

**ndërmjet**

**Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore**

**dhe**

**Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"**

**për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jo-jonizues**

**Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore dhe  
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në vijim të referuara si "Palët",**

**duke marr parasysh:**

Detyrat dhe përgjegjësitë për vlerësimin e niveleve të rrezatimi jo-jonizues, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe direktivave të Bashkimit Evropian,

Zbatimin e obligimeve që dalin nga legjislacioni në fuqi, në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jo-jonizues.

Faktin se aktualisht i vetmi institucion kompetent në aspektin shkencor, teknik-profesional në Republikën e Kosovës është Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, përkatësisht departamenti i Telekomunikacionit

Rëndësinë e shkëmbimit të përvojave ndërmjet **Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore** dhe **Universitetit të Prishtinës**

“**Hasan Prishtina**” në fushën e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të rrezatimit jo-jonizues,

**Palët janë pajtuar si në vijim:**

## **I. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit**

### **Neni 1**

#### **Shkëmbimi i informacionit teknik –profesional**

1. Palët do të shkëmbejnë informacioneve teknike-profesionale dhe shkencore në lidhje me aktivitetet që do të zhvillohen nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, departamenti i Telekomunikacionit. Kjo do të përfshijë shkëmbimin e informacioneve në vijim:
  - 1.1 Raporte tematike dhe materiale të tjera të shkruara që trajtojnë vlerësimin e niveleve të rrezatimit jo-jonizues;
  - 1.2 Rregullore, udhëzues, procedura dhe dokumente të tjera që trajtojnë licencimin dhe inspektimin e veprimtarive që janë burime të rrezatimit jo-jonizues;
  - 1.3 Njoftime të tjera operacionale dhe konsultime mbi çështje që janë të një interesi të përbashkët në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jo-jonizues.

### **Neni 2.**

#### **Shkëmbimi i përvojave**

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e licencimit dhe inspektimit të veprimtarive në ndërmarrje/veprimtari me burime të rrezatimit jo-jonizues nëpërmjet:

1. Caktimit të Ekspertëve nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, departamenti i Telekomunikacionit, për përpilimin e Raportit të vlerësimin të niveleve të rrezatimit jo-jonizues për subjektet të cilat aplikojnë për licencim, dhe pjesëmarrjen sipas mundësive në inspektime që do të kryhen nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;

2. Zhvillimit të takimeve, vizitave të punës dhe konsultimeve ndërmjet krerëve të Palëve për të diskutuar çështje të interesit të përbashkët lidhur me kontrollin në fushën e vlerësimit dhe mbrojtjes nga rrezatimi jo-jonizues.

## **II. Dispozita Administrative**

### **Neni 3**

#### **Parime të përgjithshme të bashkëpunimit**

1. Palët do të bashkëpunojnë në kuadrin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.
2. Të gjitha mosmarrëveshjet dhe çështjet mes Palëve që vijnë nga zbatimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të rregullohen me marrëveshje të ndërsjellë.
3. Ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet me pëlqimin e dyanshëm të palëve.

### **Neni 4**

#### **Mënyra e shkëmbimit të informacionit**

Palët do të vendosin ndërmjet tyre procedura të thjeshtësuara për shkëmbimin e informacionit nën këtë Memorandum Mirëkuptimi, si vijon:

1. Informacioni nën këtë Memorandum Mirëkuptimi do të shkëmbehet midis Palëve nëpërmjet korrespondencës zyrtare në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës;

2. Secila Palë do të caktojë një person kontakti për të koordinuar shkëmbimin e informacionit teknik dhe të njoftojë Palën tjetër brenda një kohe të arsyeshme nga hyrja në fuqi e këtij Memorandumi;

3. Pala që merr informacionin do të mbajë përgjegjësinë për zbatimin dhe përdorimin e çdo informacioni të shkëmbyer apo të transmetuar ndërmjet Palëve në kuadër të këtij Memorandumi;

4. Informacioni i marrë gjatë zbatimit të këtij Memorandumi do të vihet në dispozicion të institucioneve të tjera Qeveritare vetëm pas marrjes së miratimit nga të dy Palët.

### III. Dispozita përfundimtare

#### Neni 5

#### Vlefshmëria

1. Ky Memorandum do të qëndrojë në fuqi për 3 vjet, vlefshmëria e tij do të shtyhet automatikisht për një periudhë të mëtejshme 1 vjeçare dhe mund të ndryshohet me aprovimin me shkrim nga Palët.

2. Ky Memorandum i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj të fundit.

3. Secila Palë mund ta përfundojë nga ana e saj këtë Memorandum Mirëkuptimi në çdo kohë duke i dhënë të paktën 30 ditë njoftim me shkrim Palës tjetër.

4. Të gjitha aktivitetet në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit që do të fillojnë por që nuk do të përfundojnë me mbarimin e këtij Memorandumi do të vazhdojnë të kryhen deri në përfundimin e tyre në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit ose me rregullime të tjera specifike që do të arrihen në konkluzion.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përgatitur në katër (4) kopje të njëjta, prej të cilave pasi të nënshkruhet dhe protokollohet, secila palë do t'i merr nga dy (2) kopje të njëjta.

**Ky memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.**

**Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga**

**Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore**

**Beqir MEZELXHIU**

**Universiteti i Prishtinës**


**"Hasan Prishtina"**

**Prof. Dr. Marjan DEMA**



**Kryeshf Ekzekutiv**

**Data: 23/02/2018**



**Rektor IUP-së**

**Data: 23/02/2018**